

DHURIMI DHE POPULLSIA IMIGRANTE

A.I.D.O.

Shoqata Italiane për Dhurimin e Organeve, Indeve dhe Qelizave, (A.I.D.O) është një organizatë vullnetare, jo qeveritare, jo fetare, ndëretnike. Është i formuar nga qytetarë në favor të dhurimit vullnetar, anonim dhe pa pagesë, pas vdekjes, së organeve dhe indeve për transplantim terapeutik.

Është e pranishme në të gjithë territorin kombëtar me 21 zyra rajonale, 104 seksione provinciale, 1028 grupe komunale, dhe aktualisht numëron mbi 1.400.000 anëtarë.

A.I.D.O ka përfaqësuar, që nga themelimi i saj (1973), një pikë referimi dhe një shembull dialogu e bashkëbisedimi mes shoqërisë civile dhe Institucioneve.

PËRSE TË DHUROSH?

Transplantimi është një e mirë e jashtëzakonshme për mjekësinë moderne. Një transplant mund të shpëtojë jetën e pacientit, të mundësojë kushte më të mira jetese për ata që janë të detyruar tu nështrohen terapive të gjata dhe të dhimbshme si dializa ose të lejojë rifitimim e të parit. Njerëzit të cilët i janë nështuar transplantimit mund të kthehen përsëri në punë, të kenë fëmijë, të udhëtojnë, të praktikojnë sporte të ndryshme dhe të bëjnë plane për të ardhmen e tyre.

KUR MUND TË DHUROSH?

Heqja e organeve dhe indeve për transplantim bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja e një personi, dhe pasi të jetë bërë gjithçka e mundshme për ta shpëtuar atë.

Dhurues të organeve janë njerëzit e çdo moshe të cilët vdesin në spital në dhomat e kujdesit intensiv për shkak të një dëmtimi të pashërueshëm të trurit (si të gjakderdhjes, tronditjeve në kokë, aneurizëm etj) apo një pushim zemreje të zgjatur, të cilat kanë prodhuar shkatërrimin total të qelizave të trurit. Kur vdekja ndodh për shkak të ndërprerjes së të gjitha aktiviteteve të trurit, është e mundur të mbahet në mënyrë artificiale qarkullimi i gjakut dhe frymëmarrja, në mënyrë që të ruhen organet për një kohë të kufizuar.

Vërtetimi i aktit të vdekjes kryhet sipas ligjit, nga një komision i formuar nga tre specialistë (një mjek ligjor, një rianimator dhe një neurolog).

Ata kryejnë teste klinike për gjashtë orë rresht, për të përcaktuar mungesën e reflekseve të trurit ndaj stimujve të dhimbshme, frymëmarrje spontane, nëse personi është në vetëdije apo jo, e çdo aktivitet tjetër elektrik i trurit..

ZGJEDHJA PËR TË DHURUAR

Legjislacioni italian vendos çdo individ, i cili është ende në jetë, si zotërues të së drejtës personale, dhe si i tillë i jep të drejtën për tu shprehur, për dhurimin e organeve dhe indeve të tij, në mënyrë pozitive apo negative. Deklarata e Vullnetit për të Dhuruar Organet është e rregulluar me ligjin Nr. 91, datë 1 Prill 1999, si dhe Dekretit Ministror, datë 8 Prill 2000. Të shprehësh vullnetin tënd, kur je në jetë për dhurimin e organeve është një zgjedhje e ndërgjegjshme.

Ju mund të informoheni, të bashkëbisedoni me familjarët tuaj për t'ju komunikuar vendimin, dhe për të qenë i sigurt që kjo dëshirë do të respektohet.

Si mund të bëj një dhurim?

Ju mund të shprehni dëshirën apo kundërshtimin tuaj për dhurimin e organeve dhe ta ndryshoni atë në çdo kohë. Nëse ka një deklaratë të vullnetshme (pozitive ose negative) për dhurim, familja juaj nuk mund të kundërshtojë zgjedhjen e bërë në jetë nga i afërmi i tyre. Pasi është vërtetuar vullneti pozitiv i dhuruesit potencial, mjekët do të vazhdojnë me marrjen e organeve.

Në mungesë të një deklaratë të qartë nga ana e pacientit për të dhuruar, mjekët do të kryejnë marrjen e organeve, vetëm në qoftë se nga anëtarët e familjes nuk ka asnjë kundërshtim.

Ku duhet të drejtohem?

Ata që kanë arritur moshën madhore mund të shprehin dëshirën, për dhurimin e organeve dhe indeve, sipas mënyrave të mëposhtme:

- pranë sporteleve përkatëse të Qëndrave Shëndetësore;
- pranë zyrës së gjëndjes civile të Komunave të cilat kanë aktivizuar tashmë një shërbim për shpallje të vullnetit;
- duke u nënshkruar pranë Shoqatës Italiane për Dhurimin e Organeve, Indeve dhe Qelizave (AIDO) vetëm për dëshirën pozitive;
- duke plotësuar kartën blu dërguar nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2000 ose kartën të përgatitur posaçërisht nga Shoqatat dhuruese dhe të pacientëve;
- ose nëpërmjet një deklaratë në letër të thjeshtë të plotësuar me të gjitha të dhënat personale, e datuar dhe e nënshkruar prej dhuruesit.

Deklaratat që shprehin dëshirën pozitive, si dhe ato të mbledhura nga A.I.D.O, janë të regjistruara në sistemin informativ të transplantimit (SIT); bëjnë përjashtim deklaratat të hartuara në letër të thjeshtë, karta blu dhe DonorCard. Të gjitha deklaratat, duke përfshirë edhe ato që nuk regjistrohen në SIT, konsiderohen ende të vlefshme në bazë të ligjit.

PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET NJË DHURIM: RUAJTJA E ANONIMITETIT – SHËRBIMI FALAS & RESPEKTIMI I DËSHIRËS POZITIVE

Ju nuk mund të dini emrin e dhuruesit as marrësit për shkak se ligji garanton anonimitetin e të dyjave.

Organet janë ndarë në bazë të kushteve të urgjencës dhe pajtueshmërisë klinike si dhe imunologjike të njerëzve që presin transplante.

Është e paligjshme blerja ose shitja e organeve njerëzore: Dhurimi është gjithmonë në mënyrë vullnetare, pa pagesë dhe anonim.

Shpenzimet e transplantit janë në ngarkim të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar.

Organet dhe indet merren me respektin më të madh të të ndjerit. Pas marrjes, trupi i të vdekurit është në dispozicion të familjes për procedurat në lidhje me varrimin.

DHURIMI I ORGANEVE DHE INDEVE KUR JE GJALLË

Mund të dhurohen veshka dhe një pjesë e mëlçisë, mushkëritë, pankreasi dhe zorrët, qelizat gjakformuese (nga palca e eshtrave, gjakut periferik dhe gjakut të kurrizit), lëkurë, placenta dhe segmente të kockave.

Të gjitha organet e tjera dhe indet mund të dhurohen vetëm pas vdekjes.

Një përjashtim tjetër është truri dhe gjëndëra seksuale që nuk mund të jenë të dhuruara.

BESIMET FETARE

Fetë besimtare janë në favor të dhurimit të organeve. Të gjitha rekomandojnë se dhurimi është rezultat i një zgjedhjeje të lirë dhe jo të detyruar.

“Flitet për dhurimin e trupit tonë dhe të gjërave që poseidojme në Buddhizëm. Flitet për të gjitha meritat dhe virtytet tona.

Në traditën Budiste ka dhe një mënyrë të veçantë për të dhuruar organet, kur personi është ende gjallë. Në këtë rast është e nevojshme që kjo të jetë në përputhje me nivelin e praktikës sonë. Kur ne jemi të vdekur është shumë e dobishme që trupi ynë mund të shërbejë për të ndihmuar të tjerët. Pas vdekjes nuk ka pengesa”.

Shenjtëria e Tij Dalai Lama

“Ata që do të më kurojnë mua, të kujdesen për ata që janë të sëmurë”.

Mahavagga VIII.26, 1 – 8

“ Të dhurosh një organ mund të kthehet në një gjest i madh shprese e cila dhuron një ëndërr për një jetë të re për dikë tjetër. Unë lutem që kultura e dhurimit të organeve do të përhapet në shoqërinë tonë përmes krijimit të këtij rrjeti “.

Il-Myon, moncao budist dhe drejtor i Buddhist- Shoqata operate Life Share Association

“Dhurimi i organeve është e pranueshme në Theravada Budizëm. Dhënia e ndihmës në mënyrë bujare, është një virtyt budist, dhe kjo ka të bëjë me rastin e dhurimit të organeve. “

Phramaha Laow Panyasiri, Abate, Il Tempio Buddhavihara

Allahu (xh.sh.) thotë në Kuran: “Dhe në qoftë se dikush i jep jetë një personi tjetër, ajo do të quhet sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzimin”.

Sure nr.5 Ajeti 32

Një “thënie” autentike e Profetit thotë: “Nuk ka asnjë sëmundje të krijuar nga Perëndia që ai të mos ketë krijuar dhe shërimin e saj”. “Nëse ju ndodh që të jeni i sëmurë dhe keni nevojë për një transplant, ju do të dëshironit patjetër që dikush tjetër t’ju vinte në ndihmë me organin e duhur.”

Shaykh Zaki Badawi, Muslim College, Londër

Këshilli i Ligjit Islam në Britaninë e Madhe, ka deklaruar që:

1-Mjeku është autoriteti që mund të përcaktojë shenjat e vdekjes.

2-Njohuritë e tanishme mjekësore e konsiderojnë ndalimin e punimit të trurit si një përkufizim të vdekjes.

3-Këshilli pranon ndalimin e punimit të trurit si fund të jetës për qëllim të transplantimit të organeve.

4-Këshilli mbështet transplantin e organeve, si një mjet për lehtësimin e dhimbjeve, ose për të shpëtuar jetën në bazë të kushteve të Sheriatit.

5-Muslimanët mund të mbajnë kartën e dhuruesve.

6-Familjari më i afërt i të vdekurit, edhe në mungesë të një karte të dhuruesit, mund të shpreh dëshirën e tij për të dhuruar organet, për të shpëtuar jetë të tjera.

7-Dhurimi i organeve duhet të jetë falas, pa asnjë shpërblim.

8-Shitja e organeve është e ndaluar.

Në këtë botë, ne duhet të kapim rastin për veprimet vetëmohuese ndaj të tjerëve (SEVA), atëherë ne do të kemi mundësi të jetojmë në vendbanimin hyjnor.

Guru Nanak

Solidariteti dhe ndihma për ata që vuajnë janë parimet themelore të Hebrenjve; Dhurimi organeve është një akt i madh solidariteti dhe vlerë etike në të cilën nevoja për të shpëtuar një jetë njerëzore është më e rëndësishme se mundësia e fyerjes për integritetin e kufomës.

Rabinët Qëndror të Izraelit

Në shkrimet Hindu janë cituar 10 Niyamas ose 10 veprime të virtytshme: e treta është Daan, dhuratë në vetvete. Kushti i vetëm për këtë akt që të konsiderohet moralisht i drejtë është që të prodhojë efekt të dobishëm.

“Burrat arrijnë përsosjen duke bërë secili dharmën e tij të veçantë (përmbushja e detyrave),,

Bhagavad Gita

Dhurata falas e organeve pas vdekjes është e ligjshme dhe mund të jetë merituese”.

Katekizmi i Kishës Katolike

Teknika e transplantimeve ka provuar të jetë një mjet i vlefshëm për arritjen e qëllimit primar të artit mjekësor siç është shërbimi mjekësor për jetën e njeriut. Prandaj, në Letrën Vitae Enciklike Evangelium unë ju kujtoj se, mes gjeسته që ndihmojnë për të nxitur një kulturë të mirëfilltë të jetës “meriton një vlerësim të veçantë dhurimi i organeve i kryer sipas një mënyre etike të pranueshme për të ofruar një shans për shëndetin, madje edhe për jetën e të sëmurëve të cilët ndonjëherë nuk kanë asnjë shpresë tjetër” .(Nr. 86)

Giovanni Paolo II

“Në bazë të shpalljes hyjnore, Kisha pretendon besimin në ringjalljen e mishit të të vdekurit. Në ceremoninë e funeralit të krishterë, Kisha shpreh respektin për trupin e personit të vdekur. Megjithatë, dhurimi pas vdejes i organeve dhe indeve mund të bëhet një shprehje e dashurisë që shkon edhe përtej vdekjes “.

Kisha Ortodokse

DEKLARATË VULLNETI PËR DHURIMIN E ORGANEVE DHE INDEVE.

Nëse dëshiron plotëso formularin, shkëpute dhe dërgoje me postë në:

A.I.D.O. Nazionale
Via Cola di Rienzo 243
00192 Roma